



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2019

PËR

POLICINË E BURGJEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Burgjeve, si dhe i të drejtave, detyrave, marrëdhënies së punës dhe statusit të punonjësve të këtij shërbimi.

Neni 2
Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për çdo punonjës të Policisë së Burgjeve, që ushtron veprimtarinë e tij në nivel qendror, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe gjatë transferimeve e shoqërimeve të personave të dënuar dhe të paraburgosur.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. **“Punonjës i Policisë së Burgjeve”**, janë ata punonjës të Policisë së Burgjeve, në nivel qendror dhe IEVP-je, të cilët ushtrojnë detyra të natyrës

drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse apo ekzekutuese për garantimin e rendit e të sigurisë në IEVP.

2. **“IEVP”**, institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim.
3. **“Regjim i brendshëm”**, mjediset e banimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, mjediset e punës, mjediset e veprimtarive profesionale e kulturore dhe ato të përbashkëta.
4. **“Regjim i jashtëm”**, hapësira ndërmjet murit rrethues e rrethimit perimetrik, si dhe hapësira e sigurisë jashtë rrethimit perimetrik.
5. **“Lirim nga Policia e Burgjeve”**, ndërprerja e marrëdhënies juridike të punës dhe administrative të punonjësit të Policisë së Burgjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
6. **“Largim nga Policia e Burgjeve”**, ndërprerja e marrëdhënies juridike të punës dhe administrative të punonjësit të Policisë së Burgjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, pa të drejtë rikthimi në Policinë e Burgjeve.
7. **“Masat për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në IEVP”**, tërësia e veprimeve të ligjshme, të cilat duhet të kryhen nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim garantimin e rendit dhe të sigurisë.
8. **“Pajisje kufizuese”**, pajisjet që përdor Policia e Burgjeve në situata të veçanta, me qëllim garantimin e rendit dhe të sigurisë.
9. **“Siguri dinamike”**, masat e marra për të garantuar sigurinë e të dënuarve dhe të të paraburgosurve, në përputhje me nivelin e rrezikshmërisë, vlerësimin e faktorëve kriminogjenë dhe informacionet e sigurisë.
10. **“Armë”**, konsiderohet çdo mjet ose instrument, sipas kuptimit dhe kategorizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për armët.
11. **“Gatishmëri”**, konsiderohet gjendja në të cilën punonjësit e Policisë së Burgjeve mobilizohen dhe marrin masa të menjëhershme, për ruajtjen e sigurisë së personave dhe të ambienteve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
12. **“Situatë emergjente”**, një situatë e rrezikshme që përbën një kërcënim serioz, që ndikon ose mund të ndikojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në jetën dhe/apo shëndetin e të dënuarve, të punonjësve të Policisë së Burgjeve, të punonjësve të tjerë apo të personave të tjerë të pranishëm në IEVP, dhe që në

bazë të të dhënave të besueshme, rezulton se nuk mund të përballohet brenda kufijve normalë të menaxhimit e të administrimit të institucionit.

Neni 4

Statusi i Policisë së Burgjeve

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve gëzon status të veçantë, sipas këtij ligji.
2. Për çështje që nuk rregullohen nga ky ligj, do të gjejnë zbatim dispozitat e Kodit të Punës.
3. Statusi i Policisë së Burgjeve nuk ndryshon në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore.

KREU II

PARIMET E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMI I POLICISË SË BURGJEVE

SEKSIONI I

PARIMET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË

Neni 5

Ligjshmëria e veprimtarisë

1. Policia e Burgjeve garanton rendin dhe sigurinë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe gjatë shoqërimit apo transferimit të të paraburgosurve e të dënuarve me burgim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në ushtrimin e detyrës, Policia e Burgjeve siguron respektimin e të drejtave e të lirive të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, të cilat mund të kufizohen vetëm në rastet dhe mënyrat e parashikuara në ligj.

Neni 6

Objektiviteti dhe barazia

1. Policia e Burgjeve siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat e dënuar dhe të paraburgosur, pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzanisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.

2. Punonjësit e Policisë së Burgjeve ushtrojnë trajtim favorizues ndaj grave, të miturve dhe personave të tjerë, që kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë.

Neni 7

Respektimi i rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale

Punonjësi i Policisë së Burgjeve duhet të ruajë, në çdo kohë, nderin dhe dinjitetin e profesionit të tij, si dhe të sillet në mënyrë profesionale, në përputhje me ligjin e rregullat e etikës.

Neni 8

Kontrolli dhe llogaridhënia

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve është i detyruar të zbatojë urdhrat e dhënë nga eprorët, sipas shkallës funksionale dhe në raporte të barabarta, sipas hierarkisë së gradës. Urdhrat duhet të jepen në përputhje me detyrën funksionale, si dhe të mos jenë në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin dhe me dinjitetin e personit, të cilit i drejtohen.
2. Në rast të një urdhri haptazi të paligjshëm, punonjësi i Policisë së Burgjeve ka detyrimin ligjor të mos zbatojë urdhrin dhe të raportojë menjëherë paligjshmërinë e urdhrit pranë eprorit të drejtpërdrejtë të personit që ka dhënë urdhrin dhe organeve përgjegjëse për kontrollin e ligjshmërisë së Policisë së Burgjeve.
3. Në mungesë të eprorit të drejtpërdrejtë, në raste urgjente dhe kur nuk ka mundësi të komunikohet me eprorë më të lartë, funksionari me gradë më të lartë ka të drejtën e urdhrit ndaj funksionarëve të barabartë ose më të ulët.

Neni 9

Vazhdimësia e karrierës

Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtën e garantimit të karrierës, të mirëqenies dhe të vazhdimësisë në detyrë.

Neni 10

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Personeli i Policisë së Burgjeve, gjatë ushtrimit të detyrës, është i detyruar të ruajë konfidencialitetin dhe sekretin shtetëror e hetimor për fakte për të cilat vihet në dijeni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe hetimor.
2. Personelit të Policisë së Burgjeve i ndalohet të bëjë publike ose t'u japë personave të tretë të dhëna që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të

personave të dënuar e të paraburgosur, të drejtat e të miturve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave për faktet, për të cilat vihet në dijeni në përputhje me pikat 1 e 2, të këtij neni, edhe pasi ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe hetimor.

SEKSIONI II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I POLICISË SË BURGJEVE

Neni 11

Organizimi i Policisë së Burgjeve

1. Policia e Burgjeve funksionon si strukturë administrative e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që ndjek dhe realizon ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe gjatë transferimeve e shoqërimeve të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim në gjykata e institucione të tjera, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.
2. Struktura dhe organika e Policisë së Burgjeve miratohen si pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të ministrit të Drejtësisë. Pjesë e strukturës dhe e organikës së Policisë së Burgjeve, sipas kësaj pike, është dhe struktura e posaçme, që ushtron funksionet përkatëse për garantimin e ruajtjes së rendit dhe të sigurisë në regjimin e posaçëm në institucionin e sigurisë së lartë, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, si dhe mbrojtjes së posaçme, sipas pikës 2, të nenit 19, të këtij ligji.
3. Shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar dhe ato të auditimit të brendshëm për Policinë e Burgjeve kryhen nga strukturat përgjegjëse administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 12

Përgjegjësitë e Policisë së Burgjeve

1. Policia e Burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ka këto detyra:
 - a) Garanton sigurinë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe në institucionet ku shoqërohen apo transferohen të dënuarit me burgim dhe të paraburgosurit;
 - b) Merr masat e sigurisë për zhvillimin e veprimtarive të të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;

- c) Kujdeset për shoqërimin dhe sigurinë fizike të të paraburgosurve e të dënuarve me burgim, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale penale;
- ç) Zbaton rregullat e sigurisë gjatë shoqërimit apo transferimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim nga një institucion në një tjetër;
- d) Zbaton rregullat e sigurisë gjatë shoqërimit apo transferimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim për zhvillimin e seancave gjyqësore;
- dh) Siguron ruajtjen e personave të paraburgosur dhe të dënuar në spitale publike e private;
- e) Merr masa për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të personave të paraburgosur e të dënuar, si dhe të garantimit të rendit e të sigurisë së institucionit, në raste të jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore;
- ë) Kontrollon për sende të ndaluara të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim, regjimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe personelin e personat që hyjnë dhe dalin në regjimin e brendshëm;
- f) Në rastet dhe në përputhje me urdhrin e nxjerrë nga ministri i Drejtësisë, siguron shërbimin e ruajtjes fizike të objekteve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë;
- g) Vepron vetëm ose bashkëpunon me Policinë e Shtetit, ose struktura të tjera në përballimin e rasteve të jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore.

2. Përveç detyrave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) Garanton ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në regjimin e posaçëm në institucionin e sigurisë së lartë;
- b) Parandalon komunikimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë jashtë institucionit të vuajtjes së dënimit;
- c) Parandalon ndërveprimin ndërmjet personave të dënuar me burgim apo të paraburgosurve të tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë ose të organizatave të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë;
- ç) Parandalon komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të dënuarve apo të paraburgosurve që i përkasin grupimeve të ndryshme;
- d) Mbikëqyr takimet familjare të personave të dënuar me burgim apo të paraburgosurve;
- dh) Kontrollon korrespondencën e personave të dënuar me burgim apo të paraburgosurve, përveç asaj të shkëmbyer me Avokatin e Popullit, avokatët mbrojtës apo organizmat ndërkombëtarë kompetentë në fushën e të drejtave të njeriut;
- e) Garanton mbrojtjen e posaçme ndaj punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe drejtuesve të IEVP-ve, në rastet kur jeta, familja apo prona e tyre

rrezikohet nga veprime të paligjshme për shkak të detyrës që kryejnë ose kanë kryer;

ë) Kryen çdo funksion tjetër, të dhënë sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.

3. Përcaktimi i ruajtjes fizike të objekteve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë miratohet me urdhër ministri.

Neni 13

Mbajtja dhe përdorimi i armëve dhe mjeteve të tjera

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ka të drejtë të mbajë armë dhe pajisje të tjera kufizuese, vetëm në rastet e sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ndalohet të përdorë armë brenda regjimit të brendshëm të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, përveçse në situatat emergjente, sipas legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

3. Në çdo rast, ndalohet përdorimi i zinxhirëve dhe i hekurave. Përdorimi i pajisjeve të tjera kufizuese në regjimin e brendshëm të institucionit lejohet vetëm në raste të veçanta, me qëllim:

a) garantimin e rendit dhe sigurisë së institucionit apo të sigurisë fizike personale, apo shëndetit të vetë të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim;

b) parandalimin e arratisjes.

4. Përdorimi i pajisjeve të tjera kufizuese lejohet edhe gjatë një transferimi apo shoqërimi, me kusht që ato të hiqen kur i dënuari me burgim apo i paraburgosuri del përpara një organi gjyqësor ose administrativ, me përjashtim të rasteve kur organet e procedimit vendosin ndryshe.

5. Përdorimi i armëve dhe pajisjeve të tjera kufizuese sipas pikave 1, 2, 3 e 4, të këtij neni, lejohet vetëm pasi punonjësi i Policisë së Burgjeve të ketë përfunduar me sukses trajnimin e detyruar për përdorimin e mjeteve të forcës, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e personelit.

6. Në vendet ku qëndrojnë të miturit e dënuar dhe të paraburgosur, mbajtja dhe përdorimi i pajisjeve kufizuese nga punonjësit e Policisë së Burgjeve bëhen në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

7. Rregulla të hollësishme për përcaktimin e rasteve dhe mënyrës së përdorimit të armëve, të ndryshme nga ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi për

përdorimin e armëve të zjarrit, si dhe pajisjeve kufizuese, miratohen me vendim të Këshilli i Ministrave.

Neni 14 **Përdorimi i forcës**

1. Punonjësi i Policisë Burgjeve nuk përdor forcë ndaj personave të dënuar dhe të paraburgosur, me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, ose në rast të rezistencës aktive apo pasive ndaj një urdhri të ligjshëm. Në këto raste, forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk ka karakter ndëshkues.
2. Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme. Në çdo rast, ndalohet përdorimi i forcës për qëllime trajtimi çnjerëzor ose degradues.
3. Përdorimi i armëve dhe mjeteve të tjera kufizuese gjatë ushtrimit të forcës kryhet në mënyrë të përshtatshme dhe në proporcion me situatën dhe nivelin e riskut me të cilin punonjësi i Policisë së Burgjeve përballet.
4. Personeli që merret drejtpërdrejt me të burgosurit trajnohet për teknikat që e bëjnë të mundur përdorimin minimal të forcës, për të kthyer vetëkontrollin te të burgosurit agresivë.
5. Përdorimi i forcës ndaj të miturve të dënuar dhe të paraburgosur bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
6. Rregulla të hollësishme për mënyrat, teknikat dhe masat e përdorimit të forcës përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Në raste të veçanta, kur cenohet siguria dhe veprimtaria në sistemin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, Policia e Burgjeve bashkëpunon me strukturat e tjera, që veprojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë.
8. Për rastet kur punonjësit e strukturave, që veprojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë, hyjnë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të trajtuar konflikte, nga strukturat përkatëse zbatohet marrëveshja e lidhur ndërmjet ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Brendshëm. Në marrëveshje parashikohen kushtet dhe masa e të drejtave, që kanë punonjësit e secilës strukturë, llojet e ndryshme të forcës, rrethanat kur përdoret çdo lloj force, niveli i nevojshëm i kompetencave përpara se të përdoret forca dhe raportet, që duhet të përgatiten pas përdorimit të forcës.

Neni 15

Kontrolli

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron kontroll në mjedise, si dhe ndaj:
 - a) personave të dënuar me burgim apo të paraburgosur;
 - b) personave që hyjnë në regjim dhe kanë statusin e vizitorit;
 - c) personelit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.
2. Kontrollat personale kryhen nga punonjës të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar, duke siguruar jo më pak se dy punonjës.
3. Në çdo rast, ndalohet kontrolli intim ndaj personave të kontrolluar. Kontrolli intim bëhet vetëm nga mjeku i burgut, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Kontrolli i të miturve të dënuar ose të paraburgosur bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
5. Në të gjitha rastet e hyrjeve dhe të kontrolleve në mjedise, punonjësi i Policisë së Burgjeve harton një raport, ku jepen arsyet e hyrjes, të kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij.
6. Rregulla të hollësishme për rastet, llojin dhe mënyrën e ushtrimit të kontrolleve parashikohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 16

Kalimi në gatishmëri

1. Në rastet kur, të drejtat e të paraburgosurit dhe të dënuarve me burgim kufizohen ose hiqen përkohësisht në grup, me urdhër të ministrit të Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, punonjësit e Policisë së Burgjeve kalojnë në gatishmëri.
2. Kalimi në gatishmëri i Policisë së Burgjeve bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të përcaktojë masat që i përgjigjen nivelit të sigurisë në institucion, si dhe nivelin e klasifikimit të gatishmërisë, në përputhje me vlerësimin e rrezikut të situatave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.
3. Në rastet urgjente dhe në pamundësi të ndjekjes së procedurës së parashikuar në pikën 2, të këtij neni, drejtori i Policisë së Burgjeve dhe në mungesë të tij

zëvendësi, ka të drejtë të urdhërojë kalimin e menjëhershëm në gatishmëri, me kusht që jo më vonë se 24 orë të marrë miratimin e ministrit të Drejtësisë.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E POLICISË SË BURGJEVE

Neni 17

Trajtimi ekonomik dhe financiar

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve përfiton trajtimin ekonomik dhe financiar, ku përfshihen:
 - a) paga mujore, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune;
 - b) në rast pamundësie të garantimit të transportit në vendin e punës nga vetë institucioni, kompensimi për kostot shtesë për largësi nga vendbanimi, pagesat për transport apo qiranë e banesës.
2. Procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Policisë së Burgjeve, sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Për atë që nuk është e parashikuar në këtë ligj, punonjësit e Policisë së Burgjeve kanë të drejtën e përfitimit, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18

Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës

Kur punonjësi i policisë humb jetën në krye apo për shkak të detyrës, pjesëtarët e familjes përfitojnë trajtim ekonomik e financiar, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve.

Neni 19

Mbrojtja e veçantë

1. Policia e Shtetit siguron mbrojtje të veçantë fizike për punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe drejtuesit e IEVP-ve, të cilëve, për shkak të detyrës që kryejnë ose kanë kryer, u rrezikohet jeta, familja apo prona nga veprime të paligjshme të të tretëve.
2. Në situata emergjente, kur për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, është i pamundur garantimi i mbrojtjes nga Policia e Shtetit, sipas pikës 1, të këtij neni, me urdhër të ministrit të Drejtësisë ofrohet mbrojtje e veçantë për punonjësit e Policisë së Burgjeve, drejtuesit e IEVP-ve, familjen apo pasurinë e tyre nga struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve.
3. Rastet, kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë për punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe drejtuesit e IEVP-ve, sipas pikës 1, të këtij neni përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për punët e brendshme.
4. Rastet, kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë të këtyre punonjësve, sipas pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Drejtësisë.

Neni 20

Kujdesi për gratë shtatzëna

1. Punonjëset shtatzëna ose më fëmijë në gji nuk mund të kryejnë punë ose shërbime që mund të dëmtojnë shëndetin e tyre dhe të fëmijës.
2. Nuk lejohet puna e natës për punonjëset e parashikuara në pikën 1, të këtij neni.

Neni 21

E drejta për pushim

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve gëzon të drejtën e pushimit javor, pushimit vjetor të paguar dhe të pushimeve të tjera të paguara të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore në fuqi.
2. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar për punonjësit e rolit madhor dhe të lartë është 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike, për rolin të mesëm 40 (dyzet) ditë kalendarike, ndërsa për punonjësit e rolit bazë dhe punonjësit në cilësinë e aspirantit është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.
3. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve, gjatë kryerjes së lejes së pagueshme vjetore, për arsye shëndetësore bëhet i paaftë për punë dhe këtë e vërteton me raport mjekësor, njofton strukturën përgjegjëse dhe pushimi vjetor i zgjatet për atë periudhë kohe.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, përveç pushimeve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, ka të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet e martesës, të lindjes së fëmijës, sëmundjes së rëndë ose vdekjes së bashkëshortit/bashkëshortes, fëmijës, prindërve, vëllezërve dhe motrave, pësimit të dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore, ndërrimit të banesës, ndërrimit të vendbanimit të përhershëm për shkak të detyrës, përgatitjes dhe mbrojtjes së titujve pasuniversitarë për punën që kryejnë.
5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtë që, në raste të veçanta, të kërkojë leje pa të drejtë page, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten ose prindërit. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar.
6. Kriteret për dhënien dhe kohëzgjatjen e pushimeve, të parashikuara në pikat 4 e 5, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Të drejtat politike

1. Policia e Burgjeve funksionon si një strukturë e depolitizuar.
2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk mund të jetë anëtar i partive politike.
3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike, përveçse në rastet që nuk lidhen me kohën dhe ushtrimin e funksioneve publike.

Neni 23

E drejta e anëtarësimit në sindikata

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtën e pjesëmarrjes në sindikata që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të tij në marrëdhënien e punës.
2. Marrëdhëniet ndërmjet sindikatave dhe punonjësve të Policisë së Burgjeve rregullohen nëpërmjet statutit të sindikatës dhe kartës së të drejtave dhe detyrimeve që pranon çdo punonjës i Policisë së Burgjeve kur anëtarësohet.
3. Të drejtat minimale të punonjësve të Policisë së Burgjeve rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sindikatave përkatëse.

Neni 24

Ndalimi i grevës

Punonjësit të Policisë së Burgjeve i ndalohet e drejta e grevës.

Neni 25

Kufizimi i të drejtës së lëvizjes

Kufizimi i të drejtës së lëvizjes së punonjësit të Policisë së Burgjeve gjatë shërbimit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e personelit.

Neni 26

Detyrimi i përgjegjshmërisë dhe i refuzimit të urdhrave të paligjshëm

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës.
2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marra nga eprorët hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit.
3. Në rast se punonjësi i Policisë së Burgjeve e vlerëson urdhrin verbal të paligjshëm, ai kërkon nga eprori i tij që urdhri të jepet edhe me shkrim.
4. Në rast se punonjësi i Policisë së Burgjeve, edhe pas zbatimit të procedurës së parashikuar në pikën 3, të këtij neni, nga komunikimi i urdhrit deri në dhënien me shkrim të tij, vazhdon të ketë dyshime për paligjshmërinë e urdhrit të eprorit, ai nuk e zbaton atë, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.
5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka detyrimin të vërë në dijeni, pa vonesë, organet përkatëse të kontrollit të ligjshmërisë së veprimtarisë së Policisë së Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë, nëse urdhri i dhënë me shkrim, në përputhje me pikën 4, të këtij neni, është në vlerësimin e tij i paligjshëm.
6. Në çdo rast, mosrespektimi i detyrimeve dhe i procedurave që burojnë nga ky nen, nga punonjësi që ka dhënë, konfirmuar apo zbatuar urdhrin, në rast se nuk përbën vepër penale përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor.

Neni 27

Mbajtja e simboleve gjatë ushtrimit të detyrës

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve detyrohet të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e Policisë së Burgjeve vetëm gjatë kryerjes së detyrës dhe në përputhje me rregullat përkatëse ligjore.

2. Flamuri, stema, uniforma, si dhe ngjyra e shenjat në mjetet e Policisë së Burgjeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

MARRËDHËNIET E PUNËS, PRANIMI NË POLICINË E BURGJEVE DHE TRAJTIMI I PERSONELIT

Neni 28

Marrëdhëniet e punës

1. Marrëdhëniet e punës në Policinë e Burgjeve bazohen në parimet e shanseve të barabarta, të meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe pranimi kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës, transparent e të drejtë.
2. Rregullat dhe procedurat për marrëdhëniet e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës përcaktohen në rregulloren e personelit, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit të Drejtësisë.

Neni 29

Kriteret për pranimin në Policinë e Burgjeve

1. Ka të drejtë të konkurrojë për t'u pranuar në Policinë e Burgjeve çdo person që plotëson kriteret e mëposhtme:
 - a) Është shtetas shqiptar;
 - b) Ka zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) Është në kushte shëndetësore dhe fizike që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
 - ç) Ka mbaruar arsimin e mesëm;
 - d) Ndaj tij nuk është nisur një procedim penal dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - dh) Është person me figurë të pastër morale dhe me integritet shoqëror;
 - e) Ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose nuk ka masë disiplinore në fuqi;
 - ë) Është nën moshën 35 vjeç;
 - f) Nuk është larguar nga Policia e Shtetit për shkak të vlerësimeve kalimtare, ose periodike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit.
2. Personeli në institucion duhet të ketë një balancim të drejtë mes burrave dhe grave dhe të mbajë parasysh nevojat specifike që ka institucioni.

3. Pranimi në Policinë e Burgjeve bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur, që bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi kombëtar, që përfshin një testim me shkrim, një testim me gojë dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive fizike e profesionale të kandidatit.

Neni 30

Trajnimi

1. Kandidati, i cili përzgjidhet për t'u pranuar si punonjës i Policisë së Burgjeve, duhet të kryejë trajnimin bazë të Policisë së Burgjeve, në përputhje me rregulloren e personelit. Pas përfundimit të trajnimit i nënshtrohet një periudhe prove njëvjeçare, gjatë së cilës konsiderohet si aspirant në Policinë e Burgjeve. Në përfundim të periudhës së provës, aspiranti konfirmohet ose jo si punonjës i Policisë së Burgjeve.
2. Pas emërimit në pozicionin përkatës, punonjësi i Policisë së Burgjeve detyrohet të ndjekë trajnimin vazhdues të përmirësimit të aftësive profesionale të Policisë së Burgjeve, në përputhje me rregulloren e personelit.
3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve i nënshtrohet një sistemi vlerësimi vjetor, për mbarëvajtjen e tij në punë dhe përfitimin e njohurive shtesë.

Neni 31

Emërimi i punonjësve të Policisë së Burgjeve

1. Punonjësit e rolit bazë dhe të mesëm emërohen nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, mbi bazën e propozimit me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve.
2. Punonjësit e rolit të lartë drejtues emërohen nga ministri i Drejtësisë, bazuar në propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 32

Kriteret për emërimin e drejtorit të Policisë së Burgjeve

1. Drejtor i Policisë së Burgjeve mund të emërohet personi që, përveç kriterëve të parashikuara në nenin 29, të këtij ligji, me përjashtim të shkronjës “f”, të tij, mban gradën “Drejtues” dhe ka arsim të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.
2. Drejtor i Policisë së Burgjeve mund të emërohet dhe personi që nuk e mban gradën “Drejtues”, me kusht që, përveç kriterëve të parashikuara në nenin 29, të këtij ligji, me përjashtim të shkronjës “f”, të tij, të plotësojë edhe kriteret e mëposhtme:

- a) Të zotërojë, të paktën, diplomë të nivelit “Master shkencor” ose “Master profesional”, të përfutur në përfundim të ciklit të dytë të studimeve, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, të dhënë nga institucionet e arsimit të lartë, përfshirë edhe ato me status të veçantë me veprimtari në fushën e rendit dhe të mbrojtjes, apo diplomë të barasvlefshme me to, të marrë në institucione të tjera të vendit ose të huaja dhe të njohur dhe ekuivalentuar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;
- b) Të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë pune në administratën publike, polici, forcat e armatosura, profesionet e lira, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlefshëm me to, në sektorin privat;
- c) Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, sipas ligjit nr.45/2015, “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- ç) Të mos jetë subjekt i ndalimeve, sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Neni 33

Emërimi dhe lirimi i drejtorit të Policisë së Burgjeve

Drejtori i Policisë së Burgjeve emërohet dhe lirohet nga ministri i Drejtësisë, në bazë të propozimit të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

KREU V

TRANSFERIMI DHE KOMANDIMI

Neni 34

Transferimi

1. Transferimi i punonjësit të Policisë së Burgjeve mund të bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozimin me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve, vetëm për nevoja dhe në interes të punës.
2. Transferimi, si rregull, bëhet me pëlqimin e punonjësit.
3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve të rolit bazë dhe të mesëm, që nuk japin pëlqimin për transferim, paraqiten në detyrë, por mund të ushtrojnë ankim në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Në çdo rast, afati i organit kompetent për t’u shprehur mbi ankimin nuk mund të jetë më i gjatë se 30 (tridhjetë) ditë.
4. Për punonjësit e rolit bazë, transferimi lejohet deri në 45 kilometra larg vendbanimit.

Neni 35

Komandimi

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mund të komandohet me propozimin me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për mbarëvajtjen ose për përballimin e mbingarkesës së punës në sistemin e burgjeve. Periudha e komandimit nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë muaj.
2. Gjatë kohës së komandimit, punonjësit i ruhet vendi i punës, ku merr edhe pagën.
3. Në rastet kur fjetja, transporti dhe ushqimi nuk i sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, punonjësi i komanduar përfiton trajtim financiar, sipas parashikimeve të nenit 17, të këtij ligji.

KREU VI

KLASIFIKIMI I POZICIONEVE NË POLICINË E BURGJEVE

Neni 36

Klasifikimi

Pozicionet në Policinë e Burgjeve klasifikohen sipas roleve, gradave, si dhe natyrës së pozicionit përkatës. Klasifikimi bazohet në përshkrimin e punës së çdo pozicioni.

Neni 37

Rolet në Policinë e Burgjeve

1. Rolet në Policinë e Burgjeve pasqyrojnë nivelin e organizimit, të drejtimit, të kontrollit e të kryerjes së detyrave, si dhe tregojnë pozitën e punonjësve të Policisë së Burgjeve.
2. Rolet ndahen në këto kategori:
 - a) Roli i lartë;
 - b) Roli i mesëm;
 - c) Roli bazë.

Neni 38

Gradat në Policinë e Burgjeve

1. Secila nga kategoritë e parashikuara në nenin 37, të këtij ligji, klasifikohet në grada, të cilat shprehin pozitën që ka punonjësi në strukturën hierarkike të Policisë së Burgjeve.
2. Gradat për punonjës të rolit të lartë janë:

- a) drejtues i lartë (drejtor i policisë);
 - b) drejtues.
3. Gradat për punonjësin e rolit të mesëm janë:
- a) kryekomisar (shëf i sigurisë);
 - b) komisar.
4. Gradat për punonjësin e rolit bazë janë:
- a) inspektor;
 - b) nëninspektor.

Neni 39

Hierarkia e roleve dhe e gradave

1. Hierarkia ndërmjet punonjësve të Policisë së Burgjeve në role përcaktohet brenda rolit nga grada më e lartë në gradën më të ulët dhe ndërmjet roleve nga roli më i lartë te roli më i ulët.
2. Hierarkia e punonjësve të Policisë së Burgjeve me të njëjtën gradë përcaktohet nga funksioni, ndërsa për funksione të njëjta përcaktohet nga vjetërsia në gradë.

Neni 40

Marrja e gradës

1. Marrja e gradës nga punonjësi i Policisë së Burgjeve nënkupton ngritjen e tij në detyrë, sipas funksioneve korresponduese për çdo gradë.
2. Grada “Drejtues i lartë” jepet me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me emërimin në detyrë.
3. Grada “Drejtues” jepet me urdhër të ministrit të Drejtësisë, bazuar në propozimin e komisionit të vlerësimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
4. Marrja e gradës për punonjësin e rolit të mesëm “Komisar” dhe “Kryekomisar” bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozim të komisionit të vlerësimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme.
5. Marrja e gradës për rolin bazë jepet nga drejtori i Policisë së Burgjeve, me propozim të komisionit të vlerësimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme.
6. Numri i përlllogaritur për vendet e lira njoftohet brenda datës 31 mars të çdo viti.

Neni 41
Komisionet e vlerësimit

1. Komisionet e vlerësimit për dhënien e gradave për rolin bazë, të mesëm dhe të lartë, propozojnë dhënien e gradave përkatëse, në bazë të vlerësimit të kriterëve të parashikuara në këtë ligj për marrjen e gradës.
2. Përbërja dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit për dhënien e gradave, për rolin bazë dhe të mesëm, përcaktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.
3. Përbërja dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit për dhënien e gradave, për rolin e lartë, përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 42
Ecuria në gradë

1. Ecuria në gradë nga “Nëninspektor” deri në “Drejtues” bëhen kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) Është plotësuar koha e qëndrimit në gradë;
 - b) Ka përfunduar me sukses trajnimi profesional për marrjen e gradës së radhës;
 - c) Ka vlerësim vjetor pozitiv të punës, për periudhën që ka qëndruar në gradën që mban;
 - ç) Është shpallur fitues në procedurat konkurruese për ngritjen në gradë.
2. Punonjësit i lind e drejta të aplikojë për të konkurruar në procesin e përzgjedhjes, nga momenti i marrjes së gradës, në rast se ka vende të lira, pas plotësimit të kriterëve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, sipas afateve të mëposhtme:
 - a) Punonjësit e rolit bazë:

i. nga “Nëninspektor” në “Inspektor”	3vjet;
ii. nga “Inspektor” në “Komisar”	7 vjet.
 - b) Punonjësit e rolit të mesëm:

i. nga “Komisar” në “Kryekomisar”	5 vjet.
-----------------------------------	---------
 - c) Punonjësit e rolit të lartë:

i. nga “Kryekomisar” në “Drejtues”	5 vjet.
------------------------------------	---------
3. Në vjetërsinë, për efekt grade, llogaritet koha gjatë të cilës punonjësi ka kryer shërbim aktiv në strukturat e Policisë së Burgjeve dhe institucione të tjera ligjzbatuese.

4. Procedurat për kryerjen e trajnimit përkatës për marrjen e gradës së radhës përcaktohen në rregulloren e personelit të Policisë së Burgjeve, e cila duhet të përmbajë përbërjen e komisionit të testimit, kriteret për të aplikuar dhe procedurat e aplikimit.

Neni 43 **Përcaktimi i gradave në funksion**

1. Punonjësit e rolit bazë mbajnë gradat, si më poshtë vijon:
 - a) Nëninspektor, janë punonjësit e rolit ekzekutiv në detyra mbikëqyrjeje;
 - b) Inspektor, janë punonjësit e rolit bazë me funksione ekzekutive dhe kontrolluese.
2. Punonjës të nivelit të mesëm:
 - a) komisar, janë punonjës të rolit të mesëm me funksione menaxhimi dhe drejtimi brenda IEVP-së;
 - b) kryekomisar, janë punonjës të rolit të mesëm, me funksionin më të lartë drejtues për sigurinë në IEVP, specialist i policisë në DPB dhe trajner.
3. Punonjës të rolit të lartë:
 - a) drejtues, janë përgjegjës sektori në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve dhe drejtues të qendrës së trajnimit;
 - b) drejtues i lartë, është drejtori i Policisë së Burgjeve.

Neni 44 **Paraqitja e gradave**

Paraqitja, forma dhe ndërtimi i gradave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 45 **E drejta e ankimit**

1. Në rastet kur punonjësi i rolit bazë dhe të mesëm vëren shkelje të rregullave për ecurinë në gradë, ai ka të drejtë të ankohet te drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
2. Në rastet kur punonjësi i rolit të lartë vëren shkelje të rregullave për ecurinë në gradë, ai ka të drejtë të ankohet te ministri i Drejtësisë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

KREU VII **PROCEDURAT DISIPLINORE**

Neni 46

Masat disiplinore

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mban përgjegjësi administrative për veprimet ose mosveprimet e tij gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj, që bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nëse ato nuk përbëjnë vepër penale. Në këtë rast, ndaj tij mund të jepet njëra nga këto masa disiplinore:
 - a) Vërejtje me shkrim;
 - b) Vërejtje me paralajmërim;
 - c) Shtyrje e afatit të ngritjes në gradë për 1 vit;
 - ç) Largim nga Policia e Burgjeve.
2. Masa disiplinore duhet të jetë në përputhje me shkeljen e kryer, pasojat e ardhura prej saj dhe shkallën e fajësisë.
3. Efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të jetë dhënë masa disiplinore nga organi kompetent, pas marrjes dijeni të saj nga personi ndaj të cilit është marrë kjo masë.
4. Vendimi për masën disiplinore duhet t'i komunikohet me shkrim punonjësit të Policisë së Burgjeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e saj, duke e vënë në dijeni njëkohësisht edhe për të drejtën e tij të ankimit për vendimin.
5. Kategoritë dhe llojet e shkeljeve disiplinore, kriteret, rregullat, procedurat për dhënien e masave disiplinore, si dhe përbërja, organizimi dhe funksionimi i komisionit të apelimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve, përcaktohen në rregulloren e disiplinës, të miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 47

Procesi disiplinor

1. Dhënia e masave disiplinore dhe shqyrtimi i tyre bëhen sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.
2. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Për vendimin për marrjen e masës disiplinore njoftohet me shkrim i interesuari, për të cilin bëhet shënimi përkatës në dosjen vetjake.

Neni 48

Autoritetet për dhënien e masave disiplinore

Autoritetet për dhënien e masave disiplinore janë:

- a) në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve kryesisht ose me propozimin e drejtorit të Policisë së Burgjeve, ndërsa në IEVP drejtori i IEVP-së kryesisht ose me propozimin e shefit të Policisë, për masat disiplinore “Vërejtje me shkrim”.
- b) Ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për punonjësit e rolit të lartë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozimin me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve, për punonjësit e rolit të mesëm, drejtori i Policisë së Burgjeve me propozim të drejtorit të IEVP-së për punonjësit e rolit bazë dhe për punonjësin në periudhë prove në cilësinë e aspirantit, për masën disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit për 1 vit”.
- c) Ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për drejtorin dhe përgjegjësit e sektorëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për masën disiplinore “Largim nga Policia e Burgjeve”;
- ç) Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në bazë të propozimit me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve, për punonjësit e rolit bazë dhe për punonjësin në periudhë prove në cilësinë e aspirantit, për masën disiplinore “Largim nga Policia e Burgjeve”.

Neni 49

Ankimi

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit merret një masë disiplinore, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 46, të këtij ligji, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit të policisë që ka dhënë masën ndaj tij, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes dijeni për dhënien e masës disiplinore.
2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit merret një masë disiplinore, sipas shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 46, të këtij ligji, ka të drejtë të ankohet me shkrim në komisionin e apelit të masave disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga çasti i marrjes dijeni me shkrim, për dhënien e asaj mase.

Neni 50

Komisioni i apelit të masave disiplinore

1. Komisioni i apelit të masave disiplinore krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.
2. Komisioni i apelit të masave disiplinore ka kompetencë për të lënë në fuqi masën disiplinore, kur e gjen të bazuar, ta shfuqizojë atë, ose të kërkojë rishikimin e saj nga autoriteti që ka dhënë masën.

3. Përbërja dhe funksionimi i komisionit caktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 51

Afatet e shuarjes së masës disiplinore

1. Masat disiplinore “Vërejtje me shkrim” dhe “Paralajmërim me shkrim” qëndrojnë në dosjen personale të punonjësit të Policisë së Burgjeve për një periudhë prej 6 muajsh, periudhë pas së cilës shuhet.
2. Masat disiplinore “Shtyrje e afatit të ngritjes në gradë për 1 vit” qëndrojnë në dosjen personale të punonjësit të Policisë së Burgjeve për një periudhë prej një viti, nga data e përfundimit të ekzekutimit të masës, periudhë pas së cilës shuhet.
3. Pas kalimit të periudhave të përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, i gjithë dokumentacioni, që lidhet me masat disiplinore, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 46, të këtij ligji, hiqen nga dosja personale të punonjësit. Këto të dhëna nuk mund t’i bëhen të ditura asnjë institucioni apo strukture pa lejen me shkrim të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.
4. Masa disiplinore “Largim nga Policia e Burgjeve”, qëndron përgjithmonë në dosjen personale të ish-punonjësit të Policisë së Burgjeve.

Neni 52

Pezullimi

1. Në rastet kur ndaj punonjësit të Policisë së Burgjeve fillon një procedim penal ai pezullohet nga funksioni, deri në përfundim të procesit penal me vendim të formës së prerë. Gjatë kësaj periudhe, punonjësi përfiton 50 % të pagës.
2. Në rastet kur pafajësia rezulton e provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, punonjësi i Policisë së Burgjeve rikthehet në punë dhe kompensohet për pjesën e mbetur të pagës që duhej të përfitonte, nëse nuk do të ishte pezulluar.

KREU VIII

PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIEVE TË PUNËS NË POLICINË E BURGJEVE

Neni 53

Lirimi nga Policia e Burgjeve

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra kur:

- a) deklarohet i paaftë nga ana shëndetësore me vendim të komisionit përgjegjës për përcaktimin e paaftësisë;
 - b) i shkurohet funksioni organik;
 - c) punësohet në struktura të tjera të administratës publike;
 - ç) nuk kalon testimin në përfundim të kursit bazë të trajnimit;
 - d) kërkon vetë të lirohet.
2. Drejtori i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra për këto arsye:
- a) Është i paaftë nga ana shëndetësore, për një periudhë deri në 6 muaj;
 - b) Jep dorëheqjen nga detyra.
3. Punonjësit e rolit bazë dhe të mesëm lirohen nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, mbi bazën e propozimit të drejtorit të Policisë së Burgjeve.
4. Punonjësi i rolit të lartë lirohet nga ministri i Drejtësisë, bazuar në propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 54

Largimi nga Policia e Burgjeve

- 1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve largohet nga detyra nëse dënohet me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë, si dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e largimit nga Policia e Burgjeve.
- 2. Largimi i punonjësit të Policisë së Burgjeve bëhet me urdhër të autoritetit kompetent për emërimin e tij, si dhe autoriteti kompetent për dhënien e masës disiplinore të largimit nga Policia e Burgjeve.

Neni 55

Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës

- 1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, kur lirohet nga detyra, përfiton:
 - a) pagesë kalimtare;
 - b) pension të parakohshëm suplementar;
 - c) pension shërbimi;
 - ç) pension suplementar pleqërie;
 - d) vjetërsi në punë.
- 2. Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, sipas rasteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të

Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 56

Përparësia për rikthim dhe pranim në strukturat e Policisë së Burgjeve

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, që gjendet në pagesë kalimtare dhe që plotëson kushtet e kriteret për të vazhduar karrierën policore, nëse është liruar nga detyra për shkak të riorganizimit, në çdo rast ka përparësi për t'u rikthyer në shërbim.
2. Kanë përparësi për pranim në Policinë e Burgjeve shtetasit që kanë përvojë pune në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Forcat e Armatosura.

KREU IX

BASHKËPUNIMI ME SUBJEKTE TË TJERA

Neni 57

Informimi i publikut

1. Policia e Burgjeve informon publikun dhe median për kryerjen e detyrave në fushën e rendit dhe të sigurisë publike në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Policisë së Burgjeve i ndalohet që në njoftimet publike të komunikojë në mënyrë jo etike, të cenojë parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdiskriminimit dhe dinjitetin e personave të dënuar apo të paraburgosur, veçanërisht të të miturve.
3. Punonjësit të Policisë së Burgjeve i ndalohet të prononcohet në media në mënyrë individuale për çështje të cilat kanë të bëjnë me detyrën.

Neni 58

Bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore

Në përmbushjen e përgjegjësiave të saj, Policia e Burgjeve bashkëpunon me institucionet e administratës shtetërore, me personat fizikë e juridikë.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 59

Dispozita tranzitore

1. Efektet financiare të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 17, të këtij ligji, për shtesën për çdo vit vjetërsie shërbimi, do të fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2021.

2. Efektet financiare të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenin 17, të këtij ligji, për shtesën për natyrë të veçantë pune, do të fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2022.
3. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr.10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, do të qëndrojnë në fuqi dhe zbatohen, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore.

Neni 60

Aktet nënligjore zbatuese

1. Ngarkohet Këshilli Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, pika 7, 14, pika 6, 17, pika 2, 21, pika 6, 27, pika 2, 28, pika 2, dhe 44, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.
2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 46, pika 5, dhe 50, pika 3, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.
3. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për punët e brendshme të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 19, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 61

Shfuqizime

Ligji nr.10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 62

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 janar 2020.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI